



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:129167
Datë: 16.05.2024
Numri i dokumentit: 05697426

C.nr.901/19

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm gjyqtari Shaban Shala, me sekretaren juridike F.B. duke vendosur në çështjen juridike civile të paditësit N.S. nga fshati Komuna e Prizrenit të cilin e përfaqëson av.D.M. nga Prizreni kundër të paditues KS “Insig”, me seli në Prishtinë për shkak të kompensimit të dëmit, vlera kontestit 1,100.00 €, më datën 16.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESË PADIA

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesë padia e paditësit N.S. nga fshati Zhur, Komuna e Prizrenit, të cilin e përfaqëson av.D.M. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura KS “Insig”, me seli në Prishtinë, që paditësit t’ia kompenzon dëmin për të gjitha format e tij material dhe jo material të cilat rrjedhin nga aksidenti i dt.19.05.2019 më kamatë ligjore duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi N.S. nga fshati Zhur, Komuna e Prizrenit të cilin e përfaqëson av.D.M. nga Prizreni në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditues KS “Insig”, me seli në Prishtinë për shkak të kompensimit të dëmit, vlera kontestit 1,100.00 €.

I autorizuari i paditësit av.D.M. më parashtresën e dt.15.05.2024 ka deklaruar se heqë dorë nga kërkesë padia lidhur më këtë çështje kontestuese sepse palët kanë lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore për kompensimin e dëmit material.

Numri i lëndës: 2019:129167

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05697426

Prandaj gjykata në bazë dispozitive të nenit 149 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës u vendos në bazë të nenit 450 të LPK.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
-Departamenti i përgjithshëm-
C.nr.901/19, dt.16.05.2024

Sekretare juridike
Feriha Brando

Gjyqtari,
Shaban Shala

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejt ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit nëpërmjet kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.